

Monitorimi i Biodiversitetit



Në kuadër të projektit JICA, në Parkun Kombëtar Divjakë Karavasta u realizua Trajnimi i 3-të për Monitorimin dhe Identifikimin e Specieve Bimore si pjesë e Monitorimit të Biodiversitetit dhe përdorimi i aplikacionit iNaturalist.

Alfred Mullaj, Profesor në Universitetin e Tiranës dhe ëatanabe Hitoshi Ekspert i Projektit JICA mbajtën një prezantim mbi Monitorimin dhe identifikimin e llojeve të bimëve kryesisht për: llojet e rrezikuara, llojet aliene dhe invasive, llojet endemike dhe sub endemike.

Pas prezantimit, të gjithë pjesëmarrësit vazhduan trajnimin në terren duke monitoruar speciet e ndryshme bimore që gjenden pranë pjesës Godulla të PKDK

Trajnime të tjera të ndryshme do të vazhdojnë për stafin e AdZM-së për të përmirësuar identifikimin e bimëve dhe monitorimin e florës dhe habitateve të parkut.

Punonjësit e Parkut



Edion Toromani punon si specialist menaxhimi në Administratën e Zonave të Mbrojtura Fier.

Edioni punon për mbajtjen e database-it të zonave të mbrojtura, kufijtë, zonimin, kadastrën e pyjeve, aktivitetet, etj, si dhe përditësimin e tyre periodikisht.

Harton dhe mban të gjitha të dhënat nëpërmjet përdorimit të teknologjive të avancuara GIS.

Monitoron të dhënat hartografike në përputhje me objektivat e planeve të menaxhimit.

Gjithashtu bashkëpunon me strukturat përkatëse në përcaktimin e kufinjve të zonave dhe territoreve në pronësi/përdorim të njësjive vendore.

BULETINI INFORMATIV

PER MUAJIN DHJETOR 2022

Projekti për Ngritjen e Kapaciteteve Për Përmirësimin e Menaxhimit të Bazuar në Ekosistem në Parkun Kombëtar Divjakë - Karavasta



Administrata e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta
Adresa: Zyrat e Parkut 9022 Divjakë, Lushnjë
Tel: (+355) 69 890 0540
Email: dknpmmedia@hotmail.com



SCAN ME
Instagrami i
Projektit JICA



SCAN ME
Facebook
AdZM Fier

Komiteti i Menaxhimit të Parkut



Në Prefekturën e Fierit u zhvillua mbledhja e Komitetit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta. Takimi u kryesua nga Prefekti i Fierit.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Zv/Prefekti i Tiranës, zyrtarë të sektorëve të bujqësisë, peshkimit dhe turizmit, punonjës të zyrës së menaxhimit të parqeve dhe ekspertë të projektit.

Drejtori i AdZM Fier raportoi për statusin e menaxhimit të parkut dhe sfidat në drejtim të zbatimit të ligjit, monitorimit, bashkëpunimit me institucione të tjera, aktivitetëve promovuese dhe menaxhimit të turizmit.

Komiteti i Përbashkët Koordinues



Mbledhja e dytë e Komitetit të Përbashkët Koordinues u zhvillua në zyrat e prefekturës së Fierit.

Në takim morën pjesë përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Zonës së Mbrojtur, Drejtori i AdZM-së Fier, Prefekti i Qarkut Fier, Përfaqësuesi i Zyrës në Ballkan të JICA-s dhe ekspertë japonezë të Projektit.

Qëllimi kryesor i mbledhjes ishte të shqyrtojë progresin e deritanishëm të projektit dhe planin e punës për vitin e ardhshëm.

Ekspertët japonezë të Projektit prezantuan progresin që nga takimi i parë i KPK në vitin 2021. Ata gjithashtu prezantuan planin e detajuar të punës për vitin e ardhshëm.

Të gjithë anëtarët e KPK-së vlerësuan ecurinë e punës dhe shprehën mbështetjen e tyre për zbatimin e planit e paraqitur të punës së projektit në vijim.

Seminari JICA

Në kuadër të projektit u mbajt seminari "Përpjekjet dhe Progresi në Menaxhimin e Bazuar në Ekosistem në PKDK".

Qëllimi kryesor ishte të ndante progresin dhe përvojën e projektit AdZM-JICA me përfaqësues të institucioneve të ndryshme si Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencitë Rajonale të Zonave të Mbrojtura, OJQ, përfaqësues të Universiteve, ekspertet e JICA etj.

Seminari u përshëndet edhe nga Ambasadori i Japonisë në Shqipëri.

Ekspertët japonezë dhe homologët shqiptarë nga AdZM e Qarkut Fier për PKDK, prezantuan arritjet e aktivitetëve për të gjithë komponentët e deritanishëm të projektit.

Puna do të vazhdojë me zbatimin e plotë të aktivitetëve, sipas projektit me mbështetjen financiare dhe teknike të Qeverisë Japoneze

